



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr./Br. <u>16/17, 18/17</u>
Date/Datum <u>16.02.2017</u>
PRISHTINË - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY



PSH Nr. 16/17
18/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Conex Group” sh. p. k – Prishtinë, si dhe OE “Lika Trade sh. p. k” me seli në Deçan, kundër AK- Ministria e Infrastrukturës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrëth-rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i gjelbër) në rrugën nationale N9 (Hyrja e Pejës)”, me nr prok: “MI/16/082/511”, më datën 13 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Hedhen poshtë si të palejuara ankesat e OE “Conex Group sh. p. k” – Prishtinë, si dhe OE “Lika Trade sh. p. k”- Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrëth-rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i gjelbër) në rrugën nationale N9 (Hyrja e Pejës)”, me nr prok: “MI/16/082/511”, konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkizazi me nenin g paragrafi 1.26 i LPP-së.
- II. Vërtetohet, vendimi i AK-së /Ministria Infrastrukturës/, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrëth-rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i gjelbër) në rrugën nationale N9 (Hyrja e Pejës)”, me nr prok: “MI/16/082/511”.
- III. Operatoreve ekonomik ankues konform nenit 118 të LPP-së, iu kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesat janë hedhur poshtë si të palejuara.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt:24.06.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:03.08.2016, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë nëntë operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:28.12.2016, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Graniti”-Istog.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik “Lika Trade” është bërë me dt:04.1.2017.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik “Conex Group”” është bërë me dt:04.1.2017.

Vendimi në lidhje me këto dy kërkesa për rishqyrtim është marr me dt:10.01.2017

Operatori ekonomik “Conex Group” sh. p. k, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 18 janar 2017 me nr. protokolli 16/17, kundër vendimit të AK-së me titull: “Ndërtimi i rrëth- rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i gjelbër) në rrugën nationale N9 (Hyrja e Pejës)”, me nr prok: “MI/16/082/511”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1. 36 i LPP-së- 1.36. Procedura e negociuar - procedura e prokurimit që i lejon autoritetit kontraktues të ftojë dhe të këshillohet me operatorët ekonomik të zgjedhur nga ai për t’i negociuar kushtet e kontratës me njërin ose më shumë prej tyre.

Operatori ekonomik ‘Lika Trade’ sh. p. k, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 19 janar 2017 me nr. 18/17, kundër vendimit të AK-së me titull: “Ndërtimi i rrëth- rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i gjelbër) në rrugën nationale N9 (Hyrja e Pejës)”, me nr prok: “MI/16/082/511”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së- Qëllimi i ligjit
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 10 i LPP-së- Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 27 i LPP-së-Dosja e Tenderit
- Neni 52 i LPP-së-Njoftimi i kritereve për dhënen e kontratës
- Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënen e Kontratave
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së- Kriteret për dhënen e kontratave
- Neni 65 i LPP-së- Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

- Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 72 i LPP-së-Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108/A- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjes

Organit Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 02 shkurt 2017, bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë i ka rekomanduar panelit shqyrtues që të aprovoj si pjesërisht të bazuara ankesat e OE ankues “Conex Group” dhe “Lika Trade” për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të anuloj si të bazuar vendimin AK-së, njoftimi për dhënien e kontratës i datës 28 dhjetor 2016 dhe ky aktivitet i prokurimit “Ndërtimi i rrëth- rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i gjelbër) në rrugën nationale N9 (Hyrja e Pejës) me nr. prokurimi MI 16/082/511, të iniciuar nga autoriteti kontraktues- MI, në rivelësim.

Operatori ekonomik ankues “Lika Trade sh.p.k” me datë 04 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues “Conex Group sh.p.k” me datë 05 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13. 02. 2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve konform nenit 28. 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i prokurimit deklaroj: “Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe i rekomandoj panelit që të aprovojen ankesat pjesërisht të bazuara dhe lënda të kthehet në Rivlerësim”.

Në vazhdim kryetari i panelit shqyrtues pyeti ekspertin shqyrtues, se sipas cilit ligj kërkohet të nënshkruhen pasqyrat financiare nga drejtori finanziar dhe drejtori gjeneral pasi si ekspert thoni kërkohet të nënshkruhen sipas pretendimin nr. 3, në përgjigje i njëjtë deklaroj: “I sqaroj panelit shqyrtues se lidhur me këtë pyetje, në pasqyrat e prezantuara nga OE ka qenë vendi i nënshkrimit dhe emri i drejtorit finanziar dhe pronarit, ku është dashtë të vendoset nënshkrimi, dhe sipas pretendimit ankimor kam sqaruar se nuk janë vendosur nënshkrimet dhe është dashtë të jenë të vendosura në vendin përcaktuar. Në rastin konkret në dokumentin në fjalë ekziston vendi për nënshkrim nga personat konkret, dhe në at vend nuk ka nënshkrim”.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti ekspertin shqyrtues se në pretendimin 6 thoni se çështja nuk është rregulluar me LPP dhe nuk mund të jepni vlerësim, pse nuk mund të jepni vlerësim?

Në përgjigje eksperti shqyrtues deklaroj: “*Në rastin konkret nuk definohet nuk parashihet me LPP dhe nuk kam mund të jap konstatim a lejohet që pronari ti nënshkruaj vet vetit kontratë si inxhinier*”.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, si dhe gjatë deklaratave të dhëna në seancën dëgjimore, konstaton se operatori ekonomik ankues “Conex Group&Tic”- Prishtinë, me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka mundur të dëshmojë dhe të argumentojë se ka interes juridiko material konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, pasi që në asnjë variant OE ankues nuk ka mundur të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohanë t'i shkaktojë dëme materiale. Gjithashtu ky operator ekonomik nuk ka bërë asnjë pretendim ankimor për operatorin ekonomik “RSM Company” që është shpallur e përgjegjshme nga autoriteti kontraktues, e që ka ofertuar me çmim prej 1,487.412.91 €, ndërsa vetë OE ankues “Conex Group&Tic” ka ofertuar me çmim prej: 1,497.577.23 €, e që rezulton se vetë OE ankues ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se operatori tjetër i shpallur i përgjegjshëm “RSM Company”. Prandaj operator ekonomik ankues “Conex Group&Tic” në asnjë mënyrë nuk mund të jetë fitues i kontratës në këto rrethana.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “Conex Group” dhe “Lika Trade” se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar certifikatën e biznesit komplet por vetëm fletën e parë, paneli shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë nuk ka qenë ndonjë kërkesë e veçantë që OE ofertues duhet të kenë ndonjë shifër të veçantë të veprimtarisë, prandaj mungesa e të dhënavët tjera të certifikatës së biznesit nuk ndikon në rezultatin final dhe mund të konsiderohet një devijim i vogël.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Conex Group” dhe “Lika Trade” se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me pasqyrat financiare të audituara për tri vitet e fundit 2013 dhe 2015, ndërsa janë të vlefshme për vitin 2014, paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë e prezantuar në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit si dhe duke u bazuar edhe në raportin e ekspertit shqyrtues, i cili thotë vlera e kërkuar për qarkullim për tri vitet e fundit jo më pak se 4 milion euro është përbushur nga OE i rekomanduar për kontratë. Ndërsa sa i përket pjesës tjetër e ku edhe eksperti shqyrtues ka sqaruar se pasqyrat vjetore për vitin 2013 dhe 2015 nuk janë të nënshkruara nga drejtori gjeneral dhe ai financiar, paneli shqyrtues konstaton se pasqyrat vjetore të audituara janë në nënshkruara nga auditori i cili ka bërë auditimin e këtyre pasqyrave dhe i cili ka dhënë mendimin e kualifikuar, e që normalisht mban përgjegjësi për auditimin e këtyre raporteve, prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm, pasi që në FDT dhe tek njoftimi për kontratë askund nuk është kërkuar që raportet e auditimit të jenë të nënshkruara nga drejtori gjeneral dhe ai financiar te kompanise e cila auditohet, pasi që kuptohet që pasqyrat financiare përgatiten nga kompania përkatëse por auditimin e këtyre pasqyrave e bënë auditori i licencuar përkatësisht kompania audituese e që nga kjo kompani, këto raporte janë te nënshkruara dhe vulosura.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Conex Group” dhe “Lika Trade” se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar CV e inxhinierit të elektronikës z. Skënder Rugova ku janë shënuar projektet që ky inxhinier nuk ka marr pjesë dhe se ekziston një deklaratë me shkrim e inxhinierit në fjalë ku e konfirmon këtë çështje, paneli shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit të OE të rekomanduar për kontratë gjendet kontrata e nënshkruar nga OE i rekomanduar për kontratë me inxhinierin e elektroteknikes z. Skënder Rugova që të udhëheqë punimet e elektrikes në këtë projekt, prandaj kërkesa në lidhje me inxhinierin e elektros është plotësuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, pasi që në FDT nuk është kërkuar që edhe inxhinieri i elektroteknikës të ketë së paku dy projekte të realizuara, por kjo është kërkuar vetëm për menaxherin e projektit, udhëheqësin e punishtes dhe për inxhinierin e diplomuar të Gjeodezisë. Ndërsa çështjen e CV e ka sqaruar edhe operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ku ka theksuar se ka mbet shabllon nga përgatitja e CV tjera, prandaj ky është një devijim i vogël që absolutisht nuk interferon në ndonjë ndryshim të kushteve materiale konform nenit 59 paragrafi 4 pika (ii) të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Conex Group” dhe “Lika Trade” përkitazi me kontestimin e planit për menaxhimin e trafikut dhe planin dinamik të OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm, pasi që OE i rekomanduar për kontratë e ka ofruar planin dinamik dhe planin për menaxhim të trafik sipas kërkesës së AK-së, këtë e ka konfirmuar edhe eksperti shqyrtues në raportin e tij.

Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka kërkuar zyrtarisht që të ketë një kopje të ekspertizës së ekspertit shqyrtues, ndërsa lidhur me këto pretendime OE i rekomanduar për kontratë me dt: 06.02.2017 i ka dërguar Panelit shqyrtues sqarimet në detaje për secilin pretendim ankimor kontestues.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues “Lika Trade”, paneli shqyrtues sqaron se ky OE është shpallur i papërgjegjshëm nga autoriteti kontraktues dhe njëkohësisht është deklaruar i papërgjegjshëm edhe me vendim të OSHP-së nr. 335, 337/16 të dt: 27.10.2016, pasi që nuk e ka përbushur kërkesën e AK-së në lidhje kapacitetin ekonomiko financiar, e ku është kërkuar që raportet e auditimit dhe i pasqyrave të audituara të bëhen nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion, ndërsa OE ankues “Lika Trade” këto pasqyra i ka të audituara nga një auditor ligjor e jo nga kompania përkatëse e licencuar. Gjithashtu ky operator ekonomik është shpallur i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së të parashikuara në nenin 9.2 ku është kërkuar që operatorët ekonomik duhet të kenë minimum dy projekt të realizuara në lëmin e ndërtimit të rrugëve nacionale ose regionale, ndërsa ky OE ankues nuk ka ofruar dëshmi se i ka realizuar së paku dy projekte në ndërtimin e rrugëve nacionale apo regionale. Ky operator ekonomik ka ofruar dëshmi për një kontratë për mirëmbajtje të rrugëve, ndërsa tjetrën që e ka cekur për ndërtim të rrugëve ka qenë në konsorcium pikërisht me OE tanë të rekomanduar për kontratë “Graniti”, prandaj në mungesë të plotësimit të kërkesës së lartpërmendur konsiderohet i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE “Lika trade” nuk ka ofruar dëshmi të noterizuara për pajisjet që do të angazhohen në këtë projekt ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit në nenin 9.2-dëshmia 7 por e ka të noterizuar vetëm listën e pajisjeve, e nuk i ka të noterizuara edhe dëshmitë e noterizuara për pajisje veç e veç. Prandaj në mungesë të këtyre dëshmive ky OE është i papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues “Lika Trade” me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka mundur të dëshmojë dhe të argumentojë se ka interes juridiko material konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, pasi që në asnje variant OE ankues nuk ka mundur të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale.

Andaj, Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK – ‘Ministria e Infrastruktures
- 1x1 OE “Lika Trade”
- 1x1 OE & “Conex Group”
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ëeb-faqe të OSHP-së.